

DREJTËSIA SOT

Analizë nga DREJTËSIA SOT

Përmbledhje e shkurtër dhe analizim i rastit të Marigona Osmani



DREJTËSIA SOT



Analizë nga DREJTËSIA SOT

Përmbledhje e shkurtër dhe analizim i rastit të Marigona
Osmani

Autore: Elza Tullari *

Maj 2024

Kjo Analizë është hartuar në kuadër të projektit të titulluar: “JUST REACT - Nxitja e Reagimit Qytetarë drejtë përmirësimit të Qasjes në Drejtësi në Kosovë”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Fondi për Zhvillim të Komunitetit (CDF).

Përmbajtja e kësaj Analize është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

**Monitoruese në projektin “JUST REACT”*

Hyrje

Procesi penal ndaj Dardan Krivaçës dhe Arbër Sejdiut, të cilët akuzohen se kishin dhunuar dhe privuar nga jeta Marigona Osmanin, deri më tani ende nuk ka arritur në një epilog përfundimtar. Kjo ka lënë rastin e Marigona Osmanit t'i bashkangjitet grupit të rasteve në të cilat kryesit e dyshuar janë dënuar me burgim të përjetshëm, mirëpo vendimi ndaj tyre ende nuk ka marrë formë të prerë.

Përgjatë këtij punimi do të përshkruhet në tërësi rasti në fjalë, nisur nga raportimet fillestare, shqyrtimet gjyqësore, vendimi i shkallës së parë e deri tek vendimi i shkallës së dytë apo Gjykatës së Apelit. Në anën tjetër rasti do analizohet në tërësi sa i përket praktikave të cilat janë ushtruar gjatë gjykimit dhe vendimit të shkallës së parë duke u krahasuar me legjislacionin në fuqi, rrethanat në të cilat dyshohet se janë kryer veprat dhe vendimin e shkallës së dytë. Si përfundim do të arrijmë të vendosim në pah mangësitë e shfaqura nga gjykata e shkallës së parë dhe do ofrojmë rekomandime lidhur me to.

Raportimi dhe hetimi i rastit

Ky rast ishte raportuar në gusht të vitit 2021, ku Prokuroria Themelore në Ferizaj kishte pranuar një kallëzim penal lidhur me dyshimin se Dardan Krivaça në bashkëpunim me Arbër Sejdiun, kishin dhunuar dhe privuar nga jeta 18 vjeçaren Marigona Osmani. Sipas raportimeve fillestare të mediave, dy të akuzuarit të ndjerën e kishin dërguar në hapësirat e Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt dhe më pas ishin larguar nga vendi i ngjarjes.¹

Hetimet për këtë rast, prokuroria i kishte zhvilluar për rreth një vit, me ç'rast në qershor të vitit 2022 ishte ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.148/2021 në të cilën Dardan Krivaça dhe Arbër Sejdiu akuzohen për veprat penale: Vrasje e rëndë në bashkëkryerje, Dhunimi dhe Ndhimë në kryerjen e dhunimit. Në aktakuzë prokuroria pretendon se Dardan Krivaça veprën penale të dhunimit e kishte kryer në përcjellje të torturave fizike, kurse Arbër Sejdiu, akuzohet se duke qëndruar në banesën e Dardan Krivaçës, kishte ndërmarrë veprime me anë të së cilave ishte lehtësuar kryerja e dhunimit. Si rrjedhojë e kësaj, prokuroria pretendon se të njëjtët në bashkëkryerje e kishin kryer edhe veprën penale të vrasjes së rëndë.

¹ <https://drejtesiasot.com/2023/08/04/historiku-i-rastit-te-dhunimit-dhe-vrasjes-se-marigona-osmanit/>

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), për akuzat me të cilat rëndohen të pandehurit në këtë rast, parashihen dënime të larta, ku për veprën e Dhunimit nga neni 227 par.4 nënpar.4.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, parashihet dënimi deri në 15 vite, kurse për Vrasje të rëndë nga neni 173 par.1 nënpar. 1.3 dhe 1.4 të parashihet një dënim jo më pak se 10 vite, gjithashtu për këtë lloj vepre parashihet edhe dënimi kapital me burgim të përjetshëm.

Shqyrtimi gjyqësor

Procesi penal kishte vazhduar në Gjykatën Themelore të Ferizajt në të cilën ishin zhvilluar gjithsej nëntë seanca. Për gjatë të gjitha seancave, qëndrimi i dy të pandehurve kishte mbetur i njëjtë ku Dardan Krivaça nuk ishte deklaruar lidhur me fajësinë, ndërsa Arbër Sejdiu ishte deklaruar i pafajshëm. Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast është përcjellë me administrimin e provave si video-incizime, raportet e autopsisë, me dëgjimin e prindërve të viktimës si dëshmitarë, djalin e dajës së të akuzuarit Dardan Krivaça, mjekut të Spitalit të Ferizajt që ka qenë kujdestarë ditën kritike, ekspertit mjeko-ligjor, si dhe punëtorit të kompanisë i cili ka mbikëqyr incizimet e kamerave në banesën ku dyshohet se u krye dhunimi dhe vrasja e të ndjerës Marigona Osmani. Gjykata e shkallës së parë, provat e paraqitura gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor i kishte vlerësuar dhe nga to ka konstatuar se i pandehuri Dardan Krivaça kishte ushtruar dhunë të vazhdueshme ndaj viktimës e cila, sipas deklaratave të prindërve të saj të bëra në gjykatë, nuk kishte pasur fare liri, nuk i është lejuar nga i pandehuri që të komunikoj lirshëm me familjarët e saj dhe ishte e keq ushqyer.² Në fjalën përfundimtare të palëve, Dardan Krivaça para Gjykatës Themelore në Ferizaj kishte shprehur pendimin për aktin e kryer.

Më 4 gusht 2023, Gjykata Themelore e Ferizajt dy të pandehurit në këtë rast i ka liruar nga akuzat për veprat “Dhunimi” dhe “Ndihmë në kryerjen e dhunimit” për shkak të mungesës së provave, ndërsa për veprën “Vrasje e rëndë” e ka shpallur të fajshëm Dardan Krivaçën, duke e dënuar me burgim të përjetshëm. Për Arbër Sejdiun gjykata kishte bërë rikualifikimin e veprës penale në “Ndihmë në kryerjen e veprës vrasje e rëndë”, për të cilën edhe është dënuar me 15 vite burgim. Me rastin e vendimit, gjykata e shkallës së parë kishte marrë parasysh disa rrethana të cilat kryesisht ishin rënduese për dy të pandehurit. Për Dardan Krivaçën gjykata nuk kishte gjetur rrethana lehtësuese ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e lartë të përgjegjësisë së tij penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës

² Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj i dt. 06.10.2023, me numër 2022:132923, fq 24.

penale, Intensitetin e lartë të dëmtimit të vlerës së mbrojtur - e drejta në jetë, se veprën penale e kishte kryer me paramendim, nga motivi i xhelozisë dhe ndaj anëtarit të ngushtë të familjes, moshën e re të viktimës, mënyrën e kryerjes së veprës në mënyrë barbare me privim gradual nga jeta, në ambient të mbyllur ku viktimë kishte qenë e pambrojtur dhe së fundmi, si rrethanë rënduese kishte konsideruar edhe faktin se i pandehuri ishte recidivist.³

Për të pandehurin Arbër Sejdiu gjykata si rrethanë lehtësuese kishte gjetur se i njëjti nuk ishte recidivist e si rrethanë rënduese gjeti shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tij ngase i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të evitimit të dhunës e cila i është ushtruar viktimës, mirëpo ka qëndruar gjatë gjithë kohës aty, si dhe se i njëjti ka mënjanuar pengesat në kryerjen e kësaj vepre duke i pamundësuar edhe të tjerëve që të mos arrin në zbulimin e dhunës ekstreme të rëndë që ishte duke u ushtruar ndaj viktimës.⁴ Gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj po ashtu kishte bërë rikualifikimin e veprës ndaj të pandehurit Arbër Sejdiu, nga “Vrasje e rëndë në bashkëkryerje” në atë të “Ndihmës në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë” duke e vlerësuar se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive.⁵

Sipas dispozitivit të aktgjykimit, veprimet e të pandehurit Arbër Sejdiut përshkruhen se i njëjti kishte krijuar kushtet për Dardan Krivaçën që të kryej veprën penale, në atë mënyrë që mes tjerash kishte shikuar dhe përcjellë gjendjen nga vrima e derës së hyrjes, nëse ndonjë nga banoret është duke dëgjuar apo lëvizur aty pari, dhe disa herë e kishte provuar derën e hyrjes se a është e mbyllur në mënyrë të vazhdueshme për të mënjanuar pengesat.⁶

Në këtë rast mund të themi se neni 33 i KPRK-së me të cilin e ka kualifikuar shkalla e parë të pandehurin Arbër Sejdiu, gjen bazë ngase i njëjti parasheh që “*Ndihma për të kryer një vepër penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale*”. Përveç kësaj, paragrafi 1 i këtij neni parasheh që “*Kushdo që me dashje*

³ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj i dt. 06.10.2023, me numër 2022:132923, fq 49.

⁴ Po aty, fq 50.

⁵ Po aty .

⁶ Po aty, fq.3.

ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë sesa kryesi i veprës”.

Ankimimi i aktgjykimit të shkallës së parë

Ndaj këtij aktgjykimi kanë ushtruar ankesë të gjitha palët në procedurë. Këto pretendime Gjykata e Apelit i ka vlerësuar si të bazuara dhe përveç të njëjtave edhe sipas detyrës zyrtare ka vendosur që aktgjykimi të anulohet dhe çështja t’i kthehet në rigjykim Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit me numër PAKR.nr.677/23⁷, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë kishte bërë shkelje të dispozitave ligjore duke mos respektuar kushtet për hartimin e aktgjykimit sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tutje KPPRK). Prokuroria, ndër tjera, në ankesë kishte pretenduar se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte bërë rikualifikimin e veprës penale. Prokuroria kishte argumentuar se gjykata nuk kishte marrë për bazë nenin i cili i referohet privimit nga jeta të anëtarit të familjes, ndërsa Dardan Krivaça kishte qenë duke bashkëjetuar me të ndjerën, duke përmbushur kushtet për t’u zbatuar ai nen.⁸

Në anën tjetër, mbrojtësit e të akuzuarve kanë paraqitur ankesa me pretendimet se gjykata e shkallës së parë, kishte bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Sipas mbrojtësit të të pandehurit Dardan Krivaça, këto shkelje konsistojnë në atë se prokuroria dhe më pas gjykata, ditën e arrestimit të Dardan Krivaçës nuk kishin përfillur rekomandimet e personelit mjekësor që të njëjtit t’i bëhet testi për narkotik e madje as nuk është marrë deklarimi i mjekut i cili kishte konstatuar gjendjen e të pandehurit si depressive, dhe sipas mbrojtjes kjo kishte ndikuar në mbrojtjen e të pandehurit dhe zbardhjes së motivit të vërtetë të vrasjes.⁹

Tutje mbrojtësit e të pandehurit Arbër Sejdiu kishin pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk kishin hartuar vendimin sipas dispozitave ligjore të KPPRK-së pasi që provat të cila ishin prezantuar në gjykatë dhe atë, video-incizimet nga banesa e të pandehurit Dardan Krivaça, nuk ishin vlerësuar në favor të pandehurit Arbër Sejdiu.¹⁰ Edhe të dëmtuarit kanë paraqitur ankesë me pretendimet të shkeljes së ligjit penal Kodit Penal përmes vërtetimit të gabuar apo jo të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendimit të

⁷ https://apeli.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/AP_PAKR_2023-262899_SQ.pdf.

⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.677/23 dt. 22.02.2024, fq. 4 dhe 5.

⁹ Po aty, fq. 6.

¹⁰ Vendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.677/23 dt. 22.02.2024, fq. 7.

sanksionit penal.¹¹

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, në vendimin e publikuar, ka konsideruar se ankesat për shkeljet esenciale të dispozitave procedurale janë të bazuara. Sipas kësaj gjykate shkeljet konsistojnë në faktin se aktgjykimi i shkallës së parë ishte e paqartë, jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe se nuk ka paraqitur arsyetimet për çdo pikë të aktgjykimit.¹² Sidoqoftë, bazat e tjera ankimore të palëve Apeli i konsideroi jo lëndore. Gjykata e Apelit po ashtu ka vlerësuar se shkalla e parë në dispozitivin e aktgjykimit kishte marrë për bazë xhelozinë si motivi i kryerjes së veprës penale gjë e cila, sipas Apelit, nuk parashihet si element inkriminues në veprën penale për të cilën është shpallur fajtor Dardan Krivaça. Kjo pasi që dispozita me të cilën ngarkohet ky i fundit, parashih privimin nga jeta të personit tjetër në mënyrë mizore apo dinake dhe jo për motive xhelozie. Përveç kësaj Gjykata e Apelit ka argumentuar se shkalla e parë nuk kishte dhënë arsyetime për rrethanat të cilat vërtetojnë se vrasja është kryer në mënyrë mizore apo dinake dhe se kjo do të ishte vërtetuar nga Ekspertët e Mjekësisë Ligjore.¹³

Nga analizimi i këtij vendimi është vërejtur se vendimi i Gjykatës së Apelit është i bazuar edhe sa i përket faktit që shkalla e parë nuk kishte trajtuar fare pikën 1.3 të nenit 173 në të cilën parashihet privimi nga jeta i anëtarit të familjes. Gjykata e Apelit vlerësoi se kjo gjenë bazë në nenin 113 par.26 të KPRK-së ku thuhet se si anëtar i familjes konsiderohet edhe personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore. Në këto rrethana Gjykata e Apelit konsideroi se shkalla e parë është dashur të vlerësoj këtë raport mes të akuzuarit Dardan Krivaça dhe të ndjerës, sipas dispozitës së lart përmendur.¹⁴

Gjithashtu nga analizimi është vërejtur se kjo lloj marrëdhënie konsiderohet njëjtë edhe sipas Ligjit Për Parandalimin dhe Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe atë me nenin 2 par.1, pika 1.1 lidhur me pikën 1.1.3 ku thuhet se *“Marrëdhënie Familjare konsiderohen personat nëse janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore”*.¹⁵

¹¹ Vendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.677/23 dt. 22.02.2024, fq.3 dhe 4.

¹² Vendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.677/23 dt. 22.02.2024, fq. 10.

¹³ Po aty.

¹⁴ Vendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.677/23 dt. 22.02.2024, fq. 11.

¹⁵ Ligji NR. 03/L-182 Për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2 par.1, pika 1.1 lidhur me pikën 1.1.3, Gusht 2010.

Sa i përket të akuzuarit të dytë, Arbër Sejdiu, Gjykata e Apelit vlerësoi se përkundër ricilësimit, gjykata e shkallës së parë nuk kishte dhënë arsye bindëse apo prova të qarta se cilat ish-in veprimet e tij në drejtim të veprës me të cilën akuzohet dhe se këto veprime shkalla e parë i kishte vërtetuar vetëm me anë të kamerave të cilat ish-in të vendosura tek banesa e Dardan Krivaça pa i ndërlidhur ato me provat e tjera të cilat përbëjnë elementin e veprës penale.¹⁶ Si përfundim Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në aktgjykimin e shkallës së parë mungon vlerësimi dhe analizimi i provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi që nuk janë krahasuar dhe ndërlidhur me njëra tjetrën e që si rrjedhojë vlerësimi i tyre ka rezultuar i mangët, jo i drejtë dhe i palogjikshëm. Ndërsa, gjatë rigjyimit, sipas vendimit, shkalla e parë është udhëzuar që t'i përmbahet vërejtjeve të dhëna sipas këtij aktvendimi.

Politika Ndëshkimore

Në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, të nxerrë nga Gjykata Supreme, përcaktohet detyra e gjykatave që nga palët të kërkojnë që të paraqesin provat të cilat mund të vërtetojnë ekzistimin e ndonjë rrethane si ajo rënduese ashtu edhe lehtësuese. Udhëzuesi parasheh se *“Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është se gjykatat duhet të kërkojnë nga palët që të paraqesin prova të cilat mbështesin pretendimet lidhur me ekzistimin e një rrethane rënduese apo lehtësuese – vetë pretendimi i palëve për ekzistimin e një rrethane të tillë nuk mjafton”*.¹⁷ Në rastin konkret, bazuar në pretendimet e Prokurorisë se vepra penale e vrasjes së rëndë është kryer në mënyrë mizore apo dinake, gjykata e shkallës së parë të akuzuarin Dardan Krivaça e ka shpallur fajtor pa e argumentuar mizorinë apo dinakërinë me provë ashtu siç është udhëzuar edhe nga Gjykata e Apelit. Andaj edhe në këtë rast vendimi i Gjykatës së Apelit gjene bazë.

Vrasja në mënyrë mizore apo barbare, sipas Komentarit të Kodit Penal të Kosovës, konsiderohet kur kryesi, me qëllim, ose me vetëdije, ndërmerr veprime të cilat viktimës i shkaktojnë dhembje të mëdha fizike dhe psikike, ndërsa të njëjtat edhe duhet t'i tejkalojnë ato dhembje fizike dhe psikike që zakonisht paraqiten me rastin e çdo vrasjeje.¹⁸ Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar konstatimet e ekspertit të mjekësisë ligjore si të vërteta se vdekja e viktimës është bërë në mënyrë të dhunshme me lëndime të shumëfishta të shkaktuara nga shtypja, goditjet apo përplasja nga ndonjë mjet i fortë dhe të

¹⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.677/23 dt. 22.02.2024, fq. 11.

¹⁷ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore, Botimi 1, Kapitulli II, pika 2.3, Prishtinë, 2018.

¹⁸ Prof. Dr. Ismet Salihu, Mr.Sc. Hilmi Zhitija, Dr.Sc. Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, fq.476, Mars 2014 - <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>.

rëndë mbretës.¹⁹ Kjo lënë të kuptoj se në rastin konkret nuk është kontestuese se viktima ka pasur lëndime trupore nga shkaqet e lart përmendura, mirëpo problematika paraqitet në atë se gjykata nuk ka arsyetuar mizorinë e kësaj vepre në raport me rrethanat e konstatuara nga mjeku ligjor.

Pra, në rast të ekzistimit të të gjitha rrethanave me anë të së cilave do mund të vërtetohej se vrasja është kryer në mënyrë mizore, një gjë e tillë nuk mund të konstatohet vetëm nga gjykata apo të hamendësohet, mirëpo duhet të konstatohet nga mjeku ligjor e më pas të elaborohet e arsyetohet nga gjykata gjithmonë në ndërlidhje me provat tjera ekzistuese. Gjithashtu edhe sa i përket dinakërisë vlen të ceket se vrasjen në mënyrë dinake e karakterizon sjellja mashtruese apo e fshehtë me qëllim që viktima të privohet nga jeta pa rezistencë apo me rezistencë sa më të vogël, me ç'rast dorasi e shfrytëzon besimin apo sinqeritetin apo padjallëzinë e viktimës.²⁰ Gjkata e shkallës së parë në vendimin e saj nuk ka përshkruar, arsyetuar apo ndërlidhur veprimet të pandehurve në raport me viktimën gjatë kryerjes së aktit ashtu që të plotësohet si element dinakëria dhe të pandehurit në këtë rast të shpallen fajtor lidhur me të.

Konkludimi dhe Rekomandimet

Rastet e tilla, të cilat kanë vëmendje mediatike po dëshmojnë edhe një herë që ndikojnë në mënyrë indirekte në vendimet e gjyqësorit. Dënimet e shqiptuara duhet të gjejnë përputhshmëri me arsyetimet e po atyre vendimeve, në të kundërtën me atakimin e tyre në Apel, është e kuptueshme që do të kthehen në rigjykim. Ndërlidhja e gabueshme e provave njëra me tjetrën është gjithashtu një mangësi profesionale, pasojë e së cilës është rigjykimi i cili po i bën rastet që të tejzgjaten.

Ndonëse shqiptimi i dënimit është i merituar dhe është në përputhje me provat që i ka poseduar shkalla e parë në këtë rast, mungesa e arsyetimit si dhe e ndërlidhjes së tyre është një nga elementet kryesore që i duhet Apelit për ta kthyer një rast në rigjykim. Arsyetimi i vendimeve duhet të jetë në interes të të gjitha palëve, dhe nuk duhet të jetë arsyetim kufizues. Një vendim gjyqësor i cili është i strukturuar mirë, i cili i përmbanë të gjitha provat e arsyetuara tregon se rasti është dëgjuar gjithashtu siç duhet. Lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, si një element tjetër i rëndësishëm ia vlen të kujtojmë pikën

¹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj i dt. 06.10.2023, me numër 2022:132923, fq 31, 32 dhe 33.

²⁰ Prof. Dr. Ismet Salihu, Mr.Sc. Hilmi Zhitija, Dr.Sc. Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi 1, fq.477, Mars 2014 - <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>.

15 të Rekomandimit CM/Rec(2010)12²¹ të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare, për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, ku thuhet se: “*Aktgjykimet duhet të arsyetohen dhe të shpallen publikisht. Përndryshe, gjyqtarët nuk duhet të detyrohen të justifikojnë arsyet e aktgjykimeve të tyre.*”

Gjykatat e shkallës së parë duhet të kenë gjithashtu parasysht që mangësitë e tilla profesionale janë arsye kryesore në zvarritjen e rasteve, dhe presionet mediatike nuk duhet të jenë arsye që e bëjnë gjyqësorin të ndërmer vendime të cilat nuk kanë marr kohën e duhur për tu gjykuar drejtë dhe për tu arsyetuar në mënyrën e duhur. Dënimet nuk duhet të jenë dënime “të pëlqyeshme” për laikët e fushës dhe opinionin e gjerë, por duhet të jenë meritore dhe të arsyetuara. Gjykimi shoqëror për veprën penale, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit është një nga 4 arsye të qëllimit të dënimit,²² i cili në raste të tilla të zvarritjes dështon të përmbushet si qëllim gjeneral, madje edhe vet kryesi i veprës penale një situat të tillë mund ta shoh si një mundësi në zhvillimin e recidivizmit të mëtutjeshëm, duke mos i konsideruar profesionale vendimet e gjyqësorit.

²¹ <https://rm.coe.int/cmrec-2010-12-on-independence-efficiency-responsibilities-of-judges/16809f007d>

²² Neni 38, pika 1.4, KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS.



Funded by
the European Union



Group for Legal
and Political
Studies
